



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
___.12.2020

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E MODELEVE DHE SPECIFIKIMEVE TË SHENJAVE
DALLUESE TË LOGJISTIKËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Referuar nenit 99, paragrafi 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për çdo qendër votimi, materialet zgjedhore si edhe mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

Vendosja e shenjave dalluese në hyrje të ndërtesës ku ndodhet Selia e KZAZ-së, Qendra e Votimit, Vendi i Numërimit të Votave, apo numrit të Grupit të Numërimit në tavolinën e numërimit përkatëse, i shërben identifikimit të vendndodhjeve të ndërtesave si dhe vendeve ku kryhet administrim zgjedhor.

Mjeti i identifikimit të komisionerit zgjedhor, me të dhëna të komisionit dhe funksionit përkatës, do të mbahet gjatë ushtrimit të detyrës, si etikë dhe transparencë që komisioneri zgjedhor do të dëshmojë gjatë ofrimit të shërbimit për zgjedhësit dhe vëzhguesit.

Modelet e etiketës së kutisë së votimit, të kutisë së materialeve të votimit, i shërbejnë organizimit të mirë të punës, si dhe orientimit të zgjedhësit në Qendrën e Votimit. Kutia e materialeve të votimit, krahas etiketës identifikuese në faqen ballore, do të ketë edhe etiketën “Kujtesë” në kapakun e saj, për t’i ardhur në ndihmë komisionerëve të Qendrave të Votimit në kryerjen e procedurave për vendosjen e materialeve të votimit brenda saj.

Ky projektvendim nuk paraqet kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit, dhe shpenzimet do të përballohen nga buxheti i miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më lart, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim



projektvendimi “Për miratimin e modeleve dhe specifikimeve teknike të shenjave dalluese që do të përdoren për logjistikën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, modelet dhe specifikimet përkatëse bashkëlidhur tij.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: Dhjetor 2020

Nr:

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E MODELEVE DHE SPECIFIKIMEVE TË SHENJAVE DALLUESE
TË LOGJISTIKËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË
TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E N

Referuar nenit 19, paragrafi 1, gërma “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar nenit 99, paragrafi 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për çdo qendër votimi, materialet zgjedhore si edhe mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

Modelet e shenjave dalluese për identifikimin e:

- kutive të votimit;
- kutive të materialeve të votimit;
- “kuti e parregullt”, sipas përcaktimeve të nenit 115, paragrafët 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ;
- vendndodhjes së selive të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, Qendrave të



Data: Dhjetor 2020

Nr.

Për miratimin e modeleve dhe specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

- Votimit, Vendeve të Numërimit të Votave;
- numrin e Grupit të Numërimit që kryen numërimin e fletëve të votimit dhe vlerësimin e votave;
- anëtarëve të komisioneve zgjedhore (dokument identifikimi sipas nivelit të komisionit, dhe funksionit përkatës);

do të jenë pjesë e logjistikës zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Vendosja e shenjave dalluese në hyrje të ndërtesës ku ndodhet Selia e Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, Qendra e Votimit, Vendi i Numërimit të Votave, apo numrit të Grupit të Numërimit në tavolinën e numërimit përkatëse, i shërben identifikimit të vendodhjeve të ndërtesave ku dhe vendeve ku kryhet administrim zgjedhor. Ky organizim i shërben administratës zgjedhore, dhe gjithashtu është detyrim në shërbim të zgjedhësve, vëzhguesve, mediave që informojnë publikun për zhvillimin e procesit zgjedhor, si dhe për aktorët e tjerë të përfshirë në procesin zgjedhor.

Mjeti i identifikimit për funksionin dhe të dhënat e komisionit përkatës, do të mbahet dhe të përdoret nga të gjithë komisionerët zgjedhorë gjatë ushtrimit të detyrës. Mjeti i identifikimit, do të shërbejë në funksion të sjelljes etike dhe transparente që komisioneri zgjedhor do të dëshmojë gjatë ofrimit të shërbimit për zgjedhësit dhe vëzhguesit.

Modelet e etiketës së kutisë së votimit, të kutisë së materialeve të votimit, i shërbejnë organizimit të mirë të punës, si dhe orientimit të zgjedhësit në Qendrën e Votimit. Kutia e materialeve të votimit, krahas etiketës identifikuese në faqen ballore, do të ketë edhe etiketën “Kujtese” në kapakun e saj, për t’i ardhur në ndihmë komisionerëve të Qendrave të Votimit në kryerjen e procedurave për vendosjen e materialeve të votimit brenda saj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 104, paragrafi 1, nenin 115, paragrafi 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të miratojë modelet dhe specifikimet e shenjave dalluese, të cilat do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 si më poshtë:

- a) etiketë e kutisë së votimit, sipas lidhjes 1;



- b) etiketë e kutisë së materialeve të votimit, sipas lidhjes 2;
- c) etiketë e kutisë së parregullt, sipas lidhjes 3;
- ç) etiketë e kutisë së ambalazhit të materialeve zgjedhore, sipas lidhjes 4;
- d) tabela identifikuese e Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes 5;
- dh) tabela identifikuese e Qendrës së Votimit, sipas lidhjes 6;
- e) tabela identifikuese e Vendit të Numërimit të Votave, sipas lidhjes 7;
- ë) tabela identifikuese e Grupit të Numërimit të Votave, sipas lidhjes 8;
- f) dokumenti i identifikimit për anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes 9;
- g) dokumenti i identifikimit për anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, sipas lidhjes 10;
- gj) dokumenti i identifikimit për anëtarët e Grupit të Numerimit të Votave, sipas lidhjes 11;
- h) etiketë “kujtesë” për kutinë e materialeve të votimit, sipas lidhjes 12;
- i) specifikimet teknike sipas lidhjes 13.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: Dhjetor 2020

Nr:

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E MODELEVE DHE SPECIFIKIMEVE TË SHENJAVE DALLUESE
TË LOGJISTIKËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË
TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E N

Referuar nenit 19, paragrafi 1, gërma “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar nenit 99, paragrafi 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për çdo qendër votimi, materialet zgjedhore si edhe mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

Modelet e shenjave dalluese për identifikimin e:

- kutive të votimit;
- kutive të materialeve të votimit;
- “kuti e parregullt”, sipas përcaktimeve të nenit 115, paragrafët 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ;
- vendndodhjes së selive të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, Qendrave të



Data: Dhjetor 2020

Nr.

Për miratimin e modeleve dhe specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

- Votimit, Vendeve të Numërimit të Votave;
- numrin e Grupit të Numërimit që kryen numërimin e fletëve të votimit dhe vlerësimin e votave;
- anëtarëve të komisioneve zgjedhore (dokument identifikimi sipas nivelit të komisionit, dhe funksionit përkatës);

do të jenë pjesë e logjistikës zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Vendosja e shenjave dalluese në hyrje të ndërtesës ku ndodhet Selia e Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, Qendra e Votimit, Vendi i Numërimit të Votave, apo numrit të Grupit të Numërimit në tavolinën e numërimit përkatëse, i shërben identifikimit të vendodhjeve të ndërtesave ku dhe vendeve ku kryhet administrim zgjedhor. Ky organizim i shërben administratës zgjedhore, dhe gjithashtu është detyrim në shërbim të zgjedhësve, vëzhguesve, mediave që informojnë publikun për zhvillimin e procesit zgjedhor, si dhe për aktorët e tjerë të përfshirë në procesin zgjedhor.

Mjeti i identifikimit për funksionin dhe të dhënat e komisionit përkatës, do të mbahet dhe të përdoret nga të gjithë komisionerët zgjedhorë gjatë ushtrimit të detyrës. Mjeti i identifikimit, do të shërbejë në funksion të sjelljes etike dhe transparente që komisioneri zgjedhor do të dëshmojë gjatë ofrimit të shërbimit për zgjedhësit dhe vëzhguesit.

Modelet e etiketës së kutisë së votimit, të kutisë së materialeve të votimit, i shërbejnë organizimit të mirë të punës, si dhe orientimit të zgjedhësit në Qendrën e Votimit. Kutia e materialeve të votimit, krahas etiketës identifikuese në faqen ballore, do të ketë edhe etiketën “Kujtесе” në kapakun e saj, për t’i ardhur në ndihmë komisionerëve të Qendrave të Votimit në kryerjen e procedurave për vendosjen e materialeve të votimit brenda saj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 104, paragrafi 1, nenin 115, paragrafi 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të miratojë modelet dhe specifikimet e shenjave dalluese, të cilat do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 si më poshtë:

- a) etiketë e kutisë së votimit, sipas lidhjes 1;



- b) etiketë e kutisë së materialeve të votimit, sipas lidhjes 2;
- c) etiketë e kutisë së parregullt, sipas lidhjes 3;
- ç) etiketë e kutisë së ambalazhit të materialeve zgjedhore, sipas lidhjes 4;
- d) tabela identifikuese e Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes 5;
- dh) tabela identifikuese e Qendrës së Votimit, sipas lidhjes 6;
- e) tabela identifikuese e Vendit të Numërimit të Votave, sipas lidhjes 7;
- ë) tabela identifikuese e Grupit të Numërimit të Votave, sipas lidhjes 8;
- f) dokumenti i identifikimit për anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes 9;
- g) dokumenti i identifikimit për anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, sipas lidhjes 10;
- gj) dokumenti i identifikimit për anëtarët e Grupit të Numerimit të Votave, sipas lidhjes 11;
- h) etiketë “kujtesë” për kutinë e materialeve të votimit, sipas lidhjes 12;
- i) specifikimet teknike sipas lidhjes 13.


2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE


Ilirjan CELIBASHI





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

QARKU	
ZAZ NR.	
QENDRA E VOTIMIT NR.	




48 cm

40 cm

22 cm


10 cm

54 cm



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

QARKU	
ZAZ NR.	
QENDRA E VOTIMIT NR.	



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE


QARKU	
ZAZ NR.	
QENDRA E VOTIMIT NR.	

KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 25 PRILL 2021
www.kqz.gov.al

48 cm

A4



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

QARKU	
ZAZ NR.	
QENDRA E VOTIMIT NR.	

KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 25 PRILL 2021
www.kqz.gov.al

40 cm

54 cm



**KUTI
E
PARREGULLT**


**KUTI
E
PARREGULLT**

**KUTI
E
PARREGULLT**

**KUTI
E
PARREGULLT**



Etiketa Identifikuese





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU



KOMISIONI I ZONËS SË
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR Nr.

Tel:

E-mail:

Orari i punës

09:00 - 13:00
16:00 - 20:00

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 25 PRILL 2021

www.kqz.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



QARKU _____ KZAZ NR _____

QENDRA E VOTIMIT NR.

Orari i votimit **07:00 - 19:00**

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 25 PRILL 2021

www.kqz.gov.al





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

VENDI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

QARKU	
KZAZ NR.	

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 25 PRILL 2021

www.kqz.gov.al



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



QARKU _____ KZAZ NR _____


**GRUPI I
NUMËRIMIT**

NR

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 25 PRILL 2021

www.kqz.gov.al





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____
KZAZ Nr. _____

Emër Mbiemër


KRYETAR



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____
KZAZ Nr. _____

Emër Mbiemër

ZËVENDËSKRYETAR



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____
KZAZ Nr. _____

Emër Mbiemër

SEKRETAR




KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____
KZAZ Nr. _____

Emër Mbiemër

ANËTAR

KZAZ Nr. _____



KRYETAR

KZAZ Nr. _____




ZËVENDËSKRYETAR

KZAZ Nr. _____



SEKRETAR

KZAZ Nr. _____



ANËTAR





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____ KZAZ Nr. _____

KQV Nr. _____

Emer Mbiemer

KRYETAR



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____ KZAZ Nr. _____

KQV Nr. _____

Emer Mbiemer

SEKRETAR



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____ KZAZ Nr. _____

KQV Nr. _____

Emer Mbiemer


ANËTAR

KQV Nr. _____




KRYETAR

KQV Nr. _____




SEKRETAR

KQV Nr. _____



ANËTAR





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____ KZAZ Nr. _____

GNV Nr. _____

Emer Mbiemer

SEKRETAR




KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____ KZAZ Nr. _____

GNV Nr. _____

Emer Mbiemer

ANËTAR



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
QARKU _____ KZAZ Nr. _____

GNV Nr. _____

Emer Mbiemer


**NUMËRUES
I PARË**

GNV Nr. _____




SEKRETAR

GNV Nr. _____



ANËTAR

GNV Nr. _____



**NUMËRUES
I PARË**





K U J T E S E

Lidhja 12

KOMISIONERE, para se të mbyllni kutinë e materialeve zgjedhore:

1. Sigurohuni që brenda kutisë të jenë:

- ✓ Zarfi me **fletët e votimit të dëmtuara**
- ✓ Zarfi me **fletët e votimit të papërdorura**
- ✓ Lista e zgjedhësve
- ✓ Vendimet origjinale të KQV-së
- ✓ Vula e KQV-së
- ✓ Vula e kryetarit të KQV-së
- ✓ Vula me kodet e sigurisë të papërdorura
- ✓ Vula me kodet e sigurisë të dëmtuara
- ✓ Libri i Protokollit të mbledhjeve

2. Shënoni paraprakisht në **Procesverbalin për Mbylljen e Votimit** dhe në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së**:

- ✓ numrat e kodeve të sigurisë me të cilat do të mbyllni kutinë e votimit
- ✓ numrat e kodeve të sigurisë me të cilat do të mbyllni kutinë e materialeve zgjedhore.

3. Pasi të keni **vulosur Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe të keni shënuar orën e mbylljes**, vendosni:

- ✓ origjinalin e këtij procesverbali në kutinë e votimit
- ✓ kopjen e këtij procesverbali në kutinë e materialeve zgjedhore.

Kutia e materialeve zgjedhore mbyllet menjëherë me vulat me kodet e sigurisë të shënuara në procesverbalin për mbylljen e votimit.

Mosbatimi i këtyre procedurave ju ngarkon me përgjegjësi ligjore.

Nr.	Shenjat dalluese	Specifikimet teknike
1.	Etiketë e kutisë së votimit	22x10 cm/adeziv plastik
2.	Etiketë e kutisë së materialeve të votimit	A4/adeziv plastik
3.	Etiketë e kutisë së parregullt të votimit	A4/adeziv plastik
4.	Etiketë e kutisë së ambalazhit të materialeve zgjedhore	A4/adeziv plastik
5.	Tabela identifikuese e Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhore (KZAZ)	A3/leter me shkëlqim
6.	Tabela identifikuese e Qendrës së Votimit (KQV)	A3/letër me shkëlqim
7.	Tabela identifikuese e Vendit të Numërimit të Votave (VNV)	A3/letër me shkëlqim
8.	Tabela identifikuese e Grupit të Numërimit të Votave (GNV)	A3/letër me shkëlqim
9.	Dokument identifikimit për anëtarët e KZAZ-së	13 x 9 cm, karton i plastifikuar
10.	Dokument identifikimit për anëtarët e KQV-së	13 x 9 cm, karton i plastifikuar
11.	Dokument identifikimit për anëtarët e GNV-së	13 x 9 cm, karton i plastifikuar
12.	Etiketë “Kujtesë”	A5/adeziv plastik

